

VENDIM
Nr. 142, datë 24.2.2016

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TË SIPËRFAQES SË TOKËS
BUJQËSORE, NË PRONËSI SHTETËRORE, NË FSHATIN VOJNIK, NJËSIA
ADMINISTRATIVE MAQELLARË, BASHKIA DIBËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 31.4 (tridhjetë e një pikë katër) ha, në pronësi shtetërore, në fshatin Vojnik, njësi administrative Maqellarë, Bashkia Dibër, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA ME SIPËRFAQEN E TOKËS BUJQËSORE QË KALON NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI NË MBZHRAU
BASHKIA DIBËR

Nr.	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në ha	Lloji i pasurisë (arë, pemëtore, vresht, ullishte)	Statusi aktual juridik i pronësisë sipas ZVRPP-së
1	Maqellarë	Vojnik	3811	K-34-89(63-C) K-34-89(79-Δ)	2/17	31,4	Arë	Shtet